



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAVAJË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Datë \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ / 2021

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: BOE Dulla Konstruksion shpk dhe Zdravo shpk

Adresa: Tirane Qerret Fshati Qerret, Rruga Henz, godine private dy kateshe, kati 1, Nr.Pasurie 21/55, zona kadastrale Nr.3101

Procedura e prokurimit: E hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-88755-03-02-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Rikualifikimi i qendrës kulturore Aleksandër Moisiu**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme,  çmimi më i ulët

\* \* \*

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE Dulla Konstruksion shpk me NIPT L32822801B dhe Zdravo shpk me NIPT J84003411K, vlera 37,476,409 lekë
2. Edonil Konstruksion me NIPT K11519006K, vlera 36,114,880 lekë pa tvsh
3. BOE K.M.K. shpk me NIPT L78223801E, Caushi M shpk me NIPT L88419801O dhe Llazo shpk me NIPT K24218401K, vlera 26,152,000 lekë pa tvsh
4. Leon Konstruksion shpk me NIPT K71820009I, vlera 33,440,960 lekë pa tvsh
5. Shëndëlli shpk me NIPT K07924803N, vlera 35,658,850 lekë pa tvsh

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

1. Edonil Konstruksion shpk
2. BOE K.M.K shpk, Caushi M shpk dhe Llazo shpk
3. Leon Konstruksion shpk
4. Shëndëlli shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Edonil Konstruksion shpk

- Ne piken 2.3.7. te DST eshte kerkuar qe për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht për Për pajisje elektrike. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate bashkepunimi/furnizimi paraprake të vlefshme për këtë procedurë prokurimi dhe katalogun përkatës. Pajisje elektrike duhet të jenë të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.

Kontrata per furnizimin me materiale elektrike eshte lidhur me shoqerine Sali Elektrik shpk nderkohe Certifikata ISO e paraqitur eshte e skaduar dhe katalogu nuk eshte perkthyer ne gjuhen shqipe.

- Ne piken 2.3.7. te DST eshte kerkuar qe për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht për për pajisje hidrosanitare dhe hidraulike. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate bashkepunimi/furnizimi paraprake të vlefshme për këtë procedurë prokurimi dhe katalogun përkatës. Pajisje hidrosanitare dhe hidraulike duhet të jenë të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.

Eshte paraqitur kontrata e furnizimit me materialet hidraulike nderkohe Certifikata ISO dhe katalogu per materialet nuk lidhet me shoqerine me te cilen eshte nenshkruar kontrata e furnizimit.

- Ne piken 2.3.1 eshte kerkuar qe për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Për të provuar këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: – Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin publik të paraqitet formulari i vleresimit, kontrata, situacioni përfundimtar dhe situacionet progresive/pjesore, akti i kolaudimit dhe faturat tatimore përkatëse. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur Dokumenta Standarde të Tenderit 33 nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre. – Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin privat të paraqitet formulari i vleresimit, kontrata, situacioni përfundimtar, akti i kolaudimit dhe faturat tatimore përkatëse. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. – Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin publik të paraqitet formulari i vleresimit, kontratat, situacionet përfundimtare, aktet e kolaudimit dhe faturat tatimore përkatëse për secilën kontratë. Në rast se kontratat e ngjashme janë lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqiten edhe kontratat e bashkëpunimit midis tyre. – Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin privat të paraqitet formulari i vleresimit, kontratat, situacionet përfundimtare, aktet e kolaudimit dhe faturat tatimore përkatëse për secilën kontratë. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Plotësimi i njërit prej dy kushteve “a” ose “b” e bën ofertën të kualifikueshme.

Per plotesimin e ketij kriteri eshte paraqitur leja e ndertimit per object 7-9 kate sipas vendimit te K.RR.T ne vitin 2011. Referuar aktit te kolaudimit te objektit punimet kane perfunduar ne mars 2018 dhe per pasoje nuk jane Brenda 3 viteve te fundit sipas percaktimit te kriterit te mesiperm.

## 2. BOE K.M.K shpk, Caushi M shpk dhe Llazo shpk

- Ne piken 2.2.3. te DST kerkohet vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Ka detyrime (Taksa Vendore) te pashlyera ndaj Bashkisë Kavaje

## 3. Leon Konstruksion shpk

- Ne piken 2.3.7. te DST eshte kerkuar qe për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht për 1. Për pajisje hidrosanitare dhe hidraulike. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate bashkepunimi/furnizimi paraprake të vlefshme për këtë procedurë prokurimi dhe katalogun përkatës. Pajisje hidrosanitare dhe hidraulike duhet të jenë të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.

Kontrata per furnizimin me materiale hidraulike eshte lidhur me shoqerine DELTA shpk nderkohe Certifikata ISO per materialet eshte per kompani tjeter pas asnje lidhje me kompanine DELTA shpk.

- Ne piken 2.3.7. te DST eshte kerkuar qe për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht për Për pajisje elektrike. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate bashkepunimi/furnizimi paraprake të vlefshme për këtë procedurë prokurimi dhe katalogun përkatës. Pajisje elektrike duhet të jenë të çertifikuara me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.

Kontrata per furnizimin me materiale elektrike eshte lidhur me shoqerine Sali Elektrik shpk nderkohe Certifikata ISO per materialet eshte per shoqerine RIA Plastic shpk dhe nuk vertetohet asnje lidhje mes dy shoqerive.

## 4. Shëndëlli shpk

- Ne piken 2.3.8. te DST eshte kerkuar qe për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimim dhe instalimin e sistemit video (LED dhe projektor) dhe audio (bokse dhe amplifikatore). Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrate paraprake bashkepunimi/furnizimi të vlefshme për këtë procedurë prokurimi dhe katalogun përkatës. Pajisjet e mësipërme duhet te jenë te certifikuar me ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme dhe të kenë garanci me afat 2 (dy) vjet nga data e kolaudimit të punimeve.

Nuk eshte paraqitur asnje document per te vertetuar furnizimin me pajisjet audio dhe video sipas specifikimeve te parapercaktuara

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se BOE Dulla Konstruksion shpk dhe Zdravo shpk me adrese të përfaqësuesit Tirane Qerret Fshati Qerret, Rruga Henz, godine private dy kateshe, kati 1, Nr.Pasurie 21/55, zona kadastrale Nr.3101 se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 37,476,409 (tridhjetë e shtatë milion e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e nëntë) lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Kavajë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5(pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të zbatohen dispozitat që parashikohen në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 18.05.2021

Ankesa: Nuk ka patur.

Kryetari

**Redjan KRALI**